



FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION

Në bazë të nenit 27 dhe 31 të Ligjit Nr. 2003/24 për Sport, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-075, dhe

Në bazë të paragrafit 5.4, 5.5 dhe 17.3 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 14 janar 2012,

Kuvendi i Federatës së Tenisit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 24 nëntor 2018, aprovoi këtë:

STATUT

FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS



Përmbajtja

1. Emri, Forma dhe Adresa	2
2. Qëllimet dhe detyrat e Federatës	3
3. Anëtarët e Federatës	4
4. Organet e Federatës	5
5. Kuvendi.....	6
6. Bordi Ekzekutiv	7
7. Kryetari i Federatës	9
8. Sekretari i Përgjithshëm	10
9. Këshilli mbikëqyrës	10
10. Këshillat dhe komisionet e Bordit Ekzekutiv	11
11. Garat	11
12. Reprerentacionet.....	11
13. Dispozitat financiare	12
14. Shërbimi Administrativo-Profesional	13
15. Rregulloret e brendshme	13
16. Parandalimi dhe sanksionimi i dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive	14
17. Doping	14
18. Dispozita për mënjanimin e konfliktit të interesit të organeve vendim-marrëse.....	14
19. Dispozitat në lidhje me shpërbërjen e Federatës	15
20. Dispozitat kalimtare dhe të fundit.....	16
Shtojca 1 Lista e anëtarëve dhe të drejtat e votimit	17



1. Emri, Forma dhe Adresa

- 1.1. Federata e Tenisit e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Federata ose FTK) është asociacion vullnetar i shoqatave dhe organizatave të cilat për veprimtari themelore kanë sportin e tenisit.
- 1.2. Federata është person juridik dhe vepron në pajtim me Ligjin për Sport, Ligjin mbi Organizatat jofitimprurëse dhe mbi normat dhe rregullat e përcaktuara nga Federata Evropiane e Tenisit (ETF) dhe Federata Ndërkombëtare e Tenisit (ITF).
- 1.3. Emri i federatës është **Federata e Tenisit e Kosovës**, shkurtesa është **FTK**. Ndërkombëtarisht Federata do të regjistrohet me emrin **Kosovo Tennis Federation**. Selia e Federatës është në Prishtinë. Federata vepron në territorin e Republikës së Kosovës.
- 1.4. Federata e ka logon, vulën dhe flamurin e vet. Logoja është e përbërë prej reketit dhe topit. Logoja e Federatës është e mbrojtur dhe mund të përdoret vetëm me lejen e Bordit të Federatës.
- 1.5. Flamuri i Federatës ka formën e njëjtë sikurse logoja.
- 1.6. Federata e ka vulën katrore dhe të rrumbullakët, me logon e Federatës dhe me tekstin:

FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION

- 1.7. Selia-Zyra e Federatës është në Prishtinë. Adresa:

Federata e Tenisit e Kosovës
Shtëpia e Sporteve
Rr. "Agim Ramadani" Nr. 253
10000 Prishtinë

- 1.8. Federata hap xhirollogaritë e saja bankare në Republikën e Kosovës, në përputhje me dispozitat financiare të paragrafit 13.5 të këtij Statuti. Xhirollogaria aktuale është:

Banka:	Banka për Biznes Sh.a
Adresa:	Rr. Uçk-së nr. 41 10000 Prishtinë
Emri i llogarisë:	Federata e Tenisit e Kosovës
Nr. i llogarisë:	XK05-1300-0012-0000-5130
Valutat:	EUR dhe USD
Swift:	BPBXXKPR

1.9. Federata është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), e ETF dhe e ITF. Federata mund të anëtarësohet edhe në asociacione të tjera sportive vendore dhe ndërkombëtare.

Federata punon në bazë të akteve normative të veta dhe në përputhje me rregullat dhe dispozitat e ETF dhe ITF, si dhe asociacioneve të tjera në të cilat është e anëtarësuar.

1.10. Federata përfaqësohet nga Kryetari ose nga personi i autorizuar nga Kryetari.

1.11. Federata bashkëpunon me Ministrinë për Rini, Kulturë dhe Sport (Departamentin e Sportit), Shoqatën e Referëve dhe atë të Trajnerëve, Fakultetin e Edukatës Fizike, Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe shoqatat tjera sportive apo jo-sportive të cilat duan të bashkëpunojnë.

1.12. Federata e njofton opinionin publik për punën e saj nëpërmjet: Informatorëve, mjeteve të informimit si dhe përmes konferencave për media. Anëtarët e vetë i njofton nëpërmjet:

- Procesverbaleve të mbledhjeve të organeve dhe komisioneve,
- Informatorëve dhe publikimeve tjera, dhe
- Mjeteve të shkruara dhe elektronike të informimit.

2. Qëllimet dhe detyrat e Federatës

2.1. Qëllimet e Federatës janë: masovizimi, zhvillimi kualitativ dhe organizimi i tenisit; udhëheqja dhe organizimi i garave zyrtare dhe të tjera të tenisit.

2.2. Detyrat e Federatës janë:

- Udhëheqja me Reprerentacionet e Tenisit të Kosovës,
- Organizimi dhe përparimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, referëve, delegatëve.
- U ndihmon organizatave të tjera në promovimin e tenisit në të gjitha fushëveprimet e sportit të tenisit në përputhje me aktet normative.
- Merr pjesë në manifestime dhe gara ndërkombëtare,
- Mbështet zhvillimin e tenisit në vise të pazhvilluara,
- Merr pjesë në punën e KOK-ut dhe asociacioneve tjera sportive,
- Vepron kundër përdorimit të dopingut në përputhje me normat ndërkombëtare,
- Merr pjesë në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare që janë të lidhura me tenis.

3. Anëtarët e Federatës

- 3.1. Anëtarë të Federatës janë: Klubet e tenisit (publike dhe private), Shoqata e trajnerëve, Shoqata e referëve, Shoqata e lojtarëve dhe të gjitha shoqatat tjera të cilat do të pranohen si anëtarë nga Federata. Kuvendi me shumicë votash i pranon anëtarët e rinj në anëtarësi të Federatës.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për anëtarësim në Federatë janë:

- Deklarata me shkrim e Shoqatës, klubit për aplikimin dhe respektimin e Statutit dhe akteve tjera normative.
- Vërtetimi për regjistrim i Shoqatës, klubit,
- Emrat e personave të autorizuar për përfaqësim,
- Numri i xhirrollogarisë,
- Pagesa e anëtarësisë.

- 3.2. Zhvillimi i tenisit - duke i organizuar sportistët, aktivistët sportiv dhe anëtarët e tjerë që janë të përfshirë në Federatë me vullnetin e tyre - bëhet në klube.

Organizimi, të drejtat dhe detyrat e shoqatave të tenisit janë të rregulluara me statut dhe aktet tjera normative të Federatës dhe gjithashtu me rregullat ndërkombëtare të tenisit. Klubet anëtare duhet të kenë qasje në infrastrukturën e nevojshme (fushat), si dhe certifikatën e regjistrimit të klubit, në pajtueshmëri me statutin.

- 3.3. Shoqatat e trajnerëve, referëve dhe organizatave që kanë lidhje me Federatën, të drejtat dhe detyrimet e tyre, duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat dhe statutet e Federatës, ETF dhe ITF dhe aktet tjera normative të sjella nga Federatës.

3.3.1. Shoqatat e Referëve dhe Trajnerëve të Kosovës, si dhe Shoqata e Lojtarëve e Federatës, i formojnë organizatat profesionale të tenisit. Shoqatat e Trajnerëve dhe Referëve i zbatojnë politikat e tyre në pajtueshmëri me vendimet e aprovuara nga organet e Federatës. Shoqatat e Trajnerëve dhe Referëve janë të obliguara të raportojnë në formë të shkruar tek Bordi, në lidhje me aktivitetin operacional dhe financiar të tyre çdo 6 muaj. Ata janë gjithashtu të obliguar të raportojnë tek Kuvendi në lidhje me aktivitetin operacional dhe financiar të tyre, çdo vit, në mbledhjen e rregullt të Kuvendit. Statuti i Shoqatës së Trajnerëve dhe Referëve duhet të jetë në pajtueshmëri me dispozitat e këtij statuti.

3.3.2. Aktiviteti sportiv i referëve të tenisit, është i bazuar në amatorizëm, përderisa kompensimi për referim është i rregulluar me aktet normative specifike, të cilat janë të aprovuara nga Bordi.

3.3.3. Trajnerët dhe profesionistët e tjerë, i zbatojnë të drejtat e tyre, drejtpërdrejt nga klubet – organizatat e tenisit dhe punëdhënësit e tyre, bazuar në rregullat e tyre në bazat amatore. Trajnerët duhet të kenë dokumentin kualifikues të lëshuar nga organet kompetente të Federatës, ETF-së, ITF-it ose PTR (Regjistrin Profesional të Tenisit), në mënyrë që të punojnë si trajnerë nëpër klube të tenisit. Lëshimi apo refuzimi i licencës së trajnerëve është i rregulluar nga aktet normative të Shoqatës së Trajnerëve si dhe Rregullave Profesionale të Bordit, derisa të krijohen kushtet tjera.

3.4. Nëse Shoqata e Trajnerëve dhe Referëve nuk punojnë në pajtueshmëri me Statutin dhe Aktet Normative të Federatës, aktiviteti i tyre do të suspendohet automatikisht nga Bordi i Federatës, derisa të krijohen kushtet tjera të punës.

3.5. Çdo anëtar i Federatës duhet ta paguajë anëtarësinë vjetore të cilën e cakton Bordi.

3.6. Anëtari mund të dalë nga Federata atëherë kur i kryen të gjitha obligimet financiare ndaj Federatës dhe anëtarëve të tjerë të saj.

Anëtari mund të përjashtohet nga Federata kur i thyen dispozitat e Statutit dhe akteve tjera normative të Federatës, ose kur pushon së ekzistuari ose i të qenurit aktiv.

Vendimin për përjashtim nga anëtarësia e bie Kuvendi me 2/3 e votave. Efektet e përjashtimit veprojnë nga dita e marrjes së Vendimit.

3.7. Anëtari që nuk zhvillon asnjë aktivitet apo bashkëpunim me Federatën gjatë së paku një viti, me 2/3 e votave të Kuvendit mund të klasifikohet si Anëtar Joaktiv.

Anëtari Joaktiv që rifillon me aktivitete dhe bashkëpunim, në mbledhjen e radhës të Kuvendit me shumicë votash të Anëtarëve mund të riklasifikohet si Anëtar Aktiv.

3.8. Lista e Anëtarëve Aktivë dhe Joaktivë, së bashku me të drejtat e tyre të votimit, publikohet çdo vjet si Shtojcë e këtij Statuti.

4. Organet e Federatës

4.1. Organet e Federatës janë:

- Kuvendi;
- Bordi Ekzekutiv;
- Kryetari i Federatës;
- Këshilli mbikëqyrës.

5. Kuvendi

- 5.1. Kuvendi është organi më i lartë i Federatës i cili përbëhet prej delegatëve të Anëtarëve të Federatës.

Kryetari i Bordit është edhe Kryetar i Kuvendit.

Anëtarët aktivë përfaqësohen në Kuvendin e Federatës me nga tre (3) delegatë, ndërkaq Anëtarët joaktivë me një (1) delegat. Listën e Anëtarëve aktivë dhe joaktivë në uebfaqen zyrtare të Federatës e mirëmban administrata.

Në mbledhjet e Kuvendit mund të marrin pjesë delegatët e autorizuar, si dhe mysafirët e ftuar pa të drejtën e votës.

- 5.2. Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

5.2.1. Kuvendi i rregullt mbahet çdo vit, dhe atë e thërret Kryetari ose Bordi. Ftesa duhet të dërgohet më së largu 15 ditë, ndërsa materialet 7 ditë, para Kuvendit.

5.2.2. Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërrasin Kryetari, 2/3 e Anëtarëve të Federatës, 2/3 e anëtarëve të Bordit dhe Këshilli mbikqyrës. Kryetari duhet ta thërrasë Kuvendin në afat prej 30 ditëve prej ditës së kërkesës, në të kundërtën Kuvendin mund ta thërrasë edhe inicuesi. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të vendosë vetëm për çështjet për të cilat është thirrur.

- 5.3. Kuvendi mund të bie vendime vetëm nëse janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve të Federatës.

- 5.4. Kuvendi zgjedh: a) kryesinë e punës, të përbërë nga Kryetari i Federatës dhe dy anëtarë të propozuar nga delegatët; b) procesmbajtësin; c) komisionin verifikues; dhe d) trupa të tjera punues sipas nevojës.

Në mbledhje mbahet procesverbali të cilin e nënshkruajnë Kryetari dhe anëtarët e kryesisë së punës dhe procesmbajtësi. Procedura dhe mënyra e punës së Kuvendit, më hollësisht precizohen me Rregullorën e punës së Kuvendit.

5.4.1. Kuvendi, me 2/3 e votës të anëtarëve prezent, merr vendim për: a) ndryshimet statutare, b) pushimin e punës së Federatës; c) përjashtimin e Anëtarëve apo për klasifikimin e Anëtarëve si Joaktivë; dhe d) shkarkimin e Kryetarit.

5.4.2. Për çështjet që nuk janë të listuara në pikën 5.4.1 sipër, Kuvendi merr vendime me shumicën e anëtarëve prezent që kanë të drejtë vote.

5.4.3. Votimi është publik përpos kur Kuvendi vendos ndryshe, ose është e përcaktuar ndryshe me këtë Statut ose akte të tjera.

5.4.4. Vendimet e Kuvendit janë të obligueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e Federatës.

5.5. Shpenzimet e pjesemarrjës në mbledhje të Kuvendit i bartë vetë anëtari i Kuvendit.

5.6. Kuvendi në veprimtarinë e vetë i kryen këto punë:

- Aprovon statutin,
- Miraton raportet e punës të organeve të veta,
- Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e tjerë të Bordit,
- Zgjedh dhe shkarkon Këshillin mbikëqyrës,
- Zgjedh dhe shkarkon auditorin e jashtëm,
- Vendosë në lidhje me mjetet e jashtëzakonshme juridike,
- Vendos mbi faljen e dënimeve,
- Aprovon planin financiar të Federatës,
- Sajon politikën e Federatës,
- Kryen edhe punë tjera në përputhje me Statutin dhe aktet tjera të Federatës.

6. Bordi Ekzekutiv

6.1. Bordi Ekzekutiv i Federatës (shkurt “Bordi”) udhëheq me punën e Federatës në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit.

Mbledhjet e Bordit i thërret Kryetari, e në mungesë të tij njëri prej nënkryetarëve ose Sekretari i përgjithshëm. Mbledhjet janë të rregullta ose të jashtëzakonshme. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të thirret nëse për një gjë të tillë deklarohet shumica e anëtarëve të Bordit.

6.2. Bordi numëron shtatë (7) anëtarë dhe përbëhet prej: Kryetarit, dy (2) nënkryetarëve, dhe katër (4) anëtarëve të tjerë.

6.2.1. Në Bordin e Federatës duhet të jenë të përfaqësuara edhe minoritetet dhe femrat në përputhje me dispozitat e Ligjit për Sportin.

Prej numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit, së paku dy (2) duhet të jenë femra, dhe së paku një (1) nga radhët e njërit nga minoritetet e Kosovës.

Nga zgjedhjet e rregullta të vitit 2020 së paku Kryetari ose njëri nga nënkryetarët duhet të jenë të gjinisë femërore.

6.2.2. Anëtarët e Bordit zgjedhen me vota të fshehta nga Kuvendi. Lista e kandidatëve përfshin emrat e kandidatëve dhe profilet e tyre në Bord.

6.2.3. Një nënkryetar dhe dy anëtarë të tjerë të Bordit i propozon Kryetari.

6.2.4. Një nënkryetar dhe dy anëtarë të tjerë të Bordit i propozojnë Anëtarët e Kuvendit.

6.2.5. Anëtari i Bordit nuk mund të mbajë post tjetër ekzekutiv në strukturat e Federatës.

- 6.3. Kryetari, nënkryetarët dhe anëtarët e Bordit kanë mandat të rregullt katër (4) vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Zgjedhjet e rregullta mbahen me përfundimin e ciklit veror olimpik, ndërkohë që zgjedhjet apo emërimet e jashtëzakonshme kanë mandat deri në zgjedhjet e rregullta të radhës.

- 6.4. Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes në Bord rregullohen me Rregulloren mbi Punën e Bordit të cilën e aprovon Kuvendi.

Bordi mban mbledhje së paku një herë në çdo tre muaj. Kuorumi plotësohet kur në mbledhje marrin pjesë së paku katër (4) anëtarë të Bordit.

- 6.5. Bordi në veprimtarinë e punës së vetë kryen këto punë:

- Propozon Statutin dhe aktet tjera të Kuvendit,
- Përgatit mbledhjet e Kuvendit dhe materialin përcjellës,
- Ekzekuton vendimet e Kuvendit,
- Aprovon listën e zyrtareve të ndeshjeve dhe rregulloret e brendshme të Federatës,
- Përpilon planin e punës dhe atë financiar të Federatës,
- Vendos për blerjen ose shitjen e pasurisë së Federatës,
- Emëron dhe shkarkon Sekretarin e përgjithshëm,
- Aprovon planprogramin e punës së Këshillit profesional,
- Emëron dhe shkarkon trajnerët e reprezentacioneve,
- Emëron dhe shkarkon Komisararin e garave,
- Aprovon raportet e Këshillave dhe Komisioneve të Bordit,
- Miraton sistemin e garave, kalendarin dhe propozicionet e garave,
- Bartë të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës,
- Cakton lartësinë e anëtarësisë dhe kuotizimeve për anëtarët e Federatës,
- Cakton lartësinë e taksës për zyrtarë të ndeshjeve,
- Vendosë për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve në Federatë dhe për lartësinë e pagave të tyre,
- Emëron dhe shkarkon anëtarët nga Këshillat dhe Komisionet e Bordit,
- Aprovon pjesëmarrjen e reprezentacioneve sipas kalendarit të ITF/ETF;
- Vendos për vendin e Kampionatit Ekipor, varësisht kërkesës së klubeve ose sponsorëve;
- Vendos edhe për çështjet tjera të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit.

- 6.6. Bordi mund të formojë komisione dhe këshilla të përhershëm dhe ad-hoc, vendos për kompetencat e tyre dhe emëron e shkarkon anëtarët e tyre. Komisionet dhe këshillat për punën e tyre i përgjigjen Bordit.

7. Kryetari i Federatës

- 7.1. Kryetarin me vota të fshehta e zgjedh Kuvendi në përputhje me paragrafin 6.2 dhe 6.3 të Statutit.
- 7.2. Kryetari në veprimtarinë e vetë kryen këto detyra:
 - Thërret mbledhjet e Bordit, udhëheq Bordin dhe mbledhjet e Bordit;
 - Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit, dhe mund të thërrasë mbledhjet e këshillave dhe komisioneve të Bordit;
 - Përfaqëson Bordin dhe Federatën në takimet kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - Nënshkruan vendimet e Bordit dhe të Kuvendit;
 - Urdhëron ekzekutimin e plotë të planit financiar dhe të aktiviteteve;
 - Kujdeset për ligjshmërinë e punës së Federatës;
 - Ka të drejtën e votës në vendimet e Bordit dhe organeve të tjera deri në mbledhjen e parë të Kuvendit;
 - Merr vendime në rrethana të jashtëzakonshme, kur Bordi apo Kuvendi nuk mund të mbledhen, dhe informon këto organe sa më shpejt të jetë e mundur;
 - Ka të drejtën e suspendimit të ndonjë anëtari të bordit nëse anëtari nuk është aktiv ose bën veprime që janë në kundërshtim me Statutin dhe aktet normative të Federatës. Ky vendim është në fuqi, deri në mbledhjen e parë të Kuvendit;
 - Kontrollon zbatimin e vendimeve të Kuvendit dhe Bordit;
 - Zbaton dhe e udhëheq politikën e Federatës;
 - Propozon Sekretarin e Përgjithshëm;
 - Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga ky Statut dhe vendimet e Kuvendit dhe Bordit.
- 7.3. Kryetari mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit nëse vërtetohet se ka punuar në kundërshtim me Statutin. Shkarkimi i tij vendoset me vota, nëse 2/3 e delegatëve të pranishëm në Kuvend votojnë pro.
- 7.4. Nënkryetarët me vota të fshehta zgjedhen nga Kuvendi në përputhje me paragrafin 6.2 dhe 6.3 të këtij Statuti. Nënkryetarët e zëvendësojnë Kryetarin kur ky i fundit nuk është prezent në mbledhje apo takime e përfaqësime të tjera.

8. Sekretari i Përgjithshëm

- 8.1. Sekretarin e përgjithshëm e emëron Bordi me propozim të Kryetarit.
- 8.2. Sekretari i përgjithshëm në veprimtarinë e vetë i kryen këto punë:
 - Udhëheq me punën e zyrës së Federatës;
 - Ekzekuton vendimet e Kuvendit, Bordit dhe të komisioneve të Federatës;
 - Realizon bashkëpunimin me ETF, ITF, dhe federatat dhe organizatat tjera sportive jashtë Kosovës;
 - Realizon bashkëpunimin me KOK-un, Departamentin e Sporteve dhe organizatat tjera sportive në Kosovë,
 - Përgatitë mbledhjet e Kuvendit, Bordit, të Këshillave dhe Komisioneve;
 - Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve, Këshillave dhe komisioneve të Federatës në cilësinë e këshillëdhënësit;
 - Mban kontakte me mjetet e informimit;
 - Propozon Bordit, profilin e bashkëpunëtorëve profesional-administrativë;
 - Kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga aktet tjera normative të Federatës.
- 8.3. Sekretari i përgjithshëm themelon marrëdhënie të punës me Federatën në bazë të Ligjit mbi marrëdhënie të punës. Sekretari i përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para skadimit të kontratës së tij, në qoftë se nuk i kryen obligimet të cilat dalin nga aktet normative. Sekretarin e përgjithshëm në rast të mungesës së tij e zëvendëson personi të cilin e cakton Bordi.

9. Këshilli mbikëqyrës

- 9.1. Këshilli mbikëqyrës përbëhet prej tre (3) anëtarëve. Anëtarët e Këshillit i zgjedh Kuvendi me mandat të rregullt katër vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat. Anëtari i Këshillit nuk mund të jetë anëtar i organeve dhe trupave të tjera të Federatës.
- 9.2. Bordi dhe të gjitha trupat e tij janë të obliguara që Këshillit mbikëqyrës t'ia mundësojnë mbikëqyrjen në punën e tyre. Këshilli mbikëqyrës përcjell ligjshmërinë punës së Bordit, organeve dhe trupave në mes të dy Kuvendeve dhe mbikëqyr afarizmin financiar të Federatës. Këshilli mbikëqyrës i raporton për punën e vetë Kuvendit. Mënyra e punës së Këshillit mbikëqyrës më përafërsisht përcaktohet me Rregulloren mbi punën e Këshillit mbikëqyrës.
- 9.3. Këshilli mbikëqyrës takohet së paku çdo gjashtë (6) muaj.

10. Këshillat dhe komisionet e Bordit Ekzekutiv

- 10.1. Këshillat dhe komisionet krijohen nga Bordi në përputhje me paragrafin 6.6 të këtij Statuti.
- 10.2. Për mënyrën e funksionimit, numrat dhe mandatet e anëtarëve, si dhe detyrat e përgjegjësitë e këtyre këshillave dhe komisioneve nxerren rregullore të veçanta nga Bordi. Deri në atë kohë do të vlejnjë dispozitat kalimtare të parapara me paragrafin 17.2.
- 10.3. Këshillat dhe komisionet duhet të trajtojnë të gjitha sferat e veprimtarisë që ndërlidhen, por nuk kufizohen, me:
- Çështjet profesionale të avancimin profesional të klubeve, trajnerëve, lojtarëve e referëve apo punës së tyre;
 - regjistrimin e lojtarëve, rregulloret dhe mbarëvajtjen e garave;
 - trajtimin e ankesave dhe çështjeve disiplinore e sanitare;
 - selektorët dhe çështjet e tjera që ndërlidhen me reprezentacionet;
 - shpërndarjen e çmimeve dhe shpërblimeve.

11. Garat

- 11.1. Garat zyrtare në territorin e Republikës së Kosovës mund të organizohen vetëm nga Federata, ose organi i autorizuar nga Bordi i saj. Garat zhvillohen në bazë të rregulloreve të Federatës të cilat janë në harmoni rregulloreve të ETF-së dhe ITF-së.
- 11.2. Rregulloret dhe orarin e të gjitha garave i miraton Bordi.
- 11.3. Organizatorët e turneut, gjatë garës, janë të obliguar në fushë të paraqesin në vend të dukshëm logon e Federatës dhe të Ministrisë për Sport, si dhe banerët e sponzorëve të Federatës.

12. Reprezentacionet

- 12.1. Federata është e obliguar të kujdeset për reprezentacionet. Të luash për reprezentacionin e Kosovës është një obligim dhe nder për të gjithë anëtarët e saj. Federata mund të miratojë një rregullore speciale për reprezentacionet.
- 12.2. Fanelat e reprezentacionit të tenisit të Kosovës duhet ta kenë logon e Federatës dhe mbishkrimin KOSOVA.
- 12.3. Kategorizimi i reprezentacioneve të Kosovës në bazë të gjinisë dhe grupmoshës, ofrimi i fushave e pajisjeve për lojë, përzgjedhja e trajnerëve dhe stafit kompetent, stimulimi financiar i lojtarëve të reprezentacionit, financimi i sigurimit shëndetësor të tyre, stimulimi financiar i stafit profesional, obligimet e klubeve ndaj reprezentacionit, janë të rregulluara me rregulloren e reprezentacionit të Federatës.

- 12.4. Selektorët e reprezentacionit janë të emëruar nga Bordi, bazuar në propozimet e Këshillit Profesional. Mandati i tyre është katër vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Nëse selektori në të njëjtën kohë është anëtar i Këshillit Profesional, atëherë ai nuk ka drejtë të votimit në Këshill.
- 12.5. Trajnerët e reprezentacionit janë të propozuar nga Selektori i reprezentacionit dhe të nominuar nga Bordi, pas verifikimit të Këshillit profesional.
- 12.6. Në rast të nevojës për ndihmë shtesë të reprezentacionit, si përmbushja e programit të punës dhe për të zgjeruar resurset financiare, Bordi mund të nominojë Drejtorin e Reprezentacionit.
- 12.7. Secili anëtar i reprezentacionit ka për obligim të mbajë veshjet zyrtare të Federatës me logot e sponsorëve. Në rast të refuzimit, nuk mund të jetë pjesë e reprezentacionit. Nëse lojtari ka kontratë me një sponsor tjetër ai ose ajo ka të drejtë të luajë me veshje të tyre, mirëpo logoja, emri dhe ngjyra duhet të jetë e Kosovës.

13. Dispozitat financiare

- 13.1. Federata financohet nëpërmes:
 - Anëtarësisë;
 - Donacioneve;
 - Marketingut;
 - Të hyrave nga garat;
 - Të tjera burime legale.
- 13.2. Për menaxhimin e financave të Federatës është përgjegjës Kryetari, bazuar në planin financiar dhe vendimet e Kuvendit dhe të Bordit. Për ndihmë shtesë, rreth punëve financiare Federata mund të punësojë njerëz, në pajtim me ligjet për punësim.
- 13.3. Bordi miraton rregulloren financiare në bazë të cilave rregullohen:
 - Politikat financiare dhe ato kontabël;
 - Shpenzimet që mbulohen dhe procedura për rimbursimin e tyre;
 - Çmimoret për anëtarësi, shërbime të referëve, dhe të tjera;
 - Mëditjet për trajnerë, mjekë, lojtarë dhe selektorë gjatë angazhimit të tyre në reprezentacion apo në angazhimet e tjera në emër të Federatës;
 - Afatet për raportim financiar tek institucionet përkatëse, të tilla si: Ministrinë përkatëse për sport dhe administratë publike, donatorë, Kuvend.
- 13.4. Paraja e gatshme e arkëtuar lidhur me donacionet me destinim specific, do të përdoret vetëm e vetëm për atë destinim.
- 13.5. Me vendim të Bordit mund të hapen apo mbyllen xhirollogaritë bankare. Xhirollogaritë aktive publikohen në uebfaqen zyrtare të Federatës.
- 13.6. Kuvendi mund të miratojë mëditje, për mbledhje, që mund t'i ofrohen:
 - Anëtarëve të Bordit;
 - Anëtarëve të Këshillave dhe Komisioneve të Kuvendit apo të Bordit.

14. Shërbimi Administrativo-Profesional

- 14.1. Federata mund të punësojë staf shtesë, të cilët do të punojnë në shërbimin profesional dhe administrativ. Për punësimin e tyre dhe lartësinë e pagës vendos Bordi, sipas propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm.
- 14.2. Federata mund të punësojë staf shtesë nëse duhet ndihmë në udhëheqjen e ndonjë gare vendore.

15. Rregulloret e brendshme

- 15.1. Rregulloret e brendshme dhe propozicionet e garave nuk guxojnë të pësojnë ndryshime, gjatë edicionit garues i cili është në rrjedhë e sipër. Përjashtim nga kjo bëjnë rastet kur jo çdo gjë është e precizuar mjaftueshëm me rregulloret përkatëse, me ç'rast Bordi mund të nxjerr vendim i cili rregullon / precizon çështjen.
- 15.2. Në procedurat administrative që janë të lidhura me strukturat kompetente të Federatës, mund të përdoren mjete të rregullta apo mjete juridike të jashtëzakonshme. Për çështje administrative që nuk janë të rregulluara me këtë Statut, përdoren dispozitat e kodit për procedurat administrative.
- 15.3. Për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave dhe organizatave në bashkëpunim me Federatën mund të vendos Bordi vetëm në rastet kur ato nuk janë të përfshira në këtë Statut. Vendimet e Bordit që janë marrë në përputhje me paragrafin 15.1 të këtij Statuti janë finale dhe ankesë ndaj tyre nuk lejohet.
- 15.4. Kundër vendimeve të komisioneve dhe strukturave të tjera të Bordit, mund të iniciohet ankesë e cila duhet t'i dorëzohet Bordit në afat prej 8 ditësh nga publikimi a dorëzimi i vendimit. Bordi është i obliguar të vendos bazuar në rregulloret përkatëse, jo më vonë se 30 ditë prej ditës që është bërë ankesa. Vendimi i Bordit duhet të dërgohet prapa jo më vonë se 8 ditë pas vendimit.
- 15.5. Nëse në aktin final të autoriteteve ose strukturave tjera të Bordit, ka ndonjë ndërhyrje në miratimin e marrëveshjes, miratimin e Statutit dhe akteve tjera normative të Federatës, atëherë personi i interesuar, autoriteti ose organizata mund të iniciojë procedurën për mbrojtje ligjore. Ankesa me shkrim mund t'i dërgohet Kryetarit të Kuvendit, në periudhën 30 ditore.
- 15.6. Komisioni i Bordit për aktet normative është i obliguar që 15 ditë prej ditë së pranimit të ankesës, të përgatisë opinion me shkrim në lidhje me meritat e ankesës dhe t'ia dërgojë Kryetarit të Kuvendit. Kryetari është i obliguar të marr vendimin në lidhje me atë ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të opinionit nga komisioni.
- 15.7. Kryetari i Kuvendit mund të refuzojë propozimin për kërkesë për mbrojtje ligjore, nëse ajo është prezantuar pas kalimit të afatit të caktuar. Vendimi është final dhe kërkesa shtesë nuk lejohen. Nëse Kryetari i Kuvendit dëshmon se propozimi është dërguar me kohë, ai do ta dërgoj atë propozim te Bordi, në periudhën prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
- 15.8. Në rast se vendimi në lidhje kërkesën për mbrojtje ligjore është marrë, Bordi është i obliguar t'i dërgojë kërkesë-bërësit vendimin në lidhje me kërkesën, më së largu deri në 30 ditë.

16. Parandalimi dhe sanksionimi i dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive

- 16.1. FTK krijon organet e gjykimit disiplinor, sipas procedurave të percaktuara në rregulloret e miratuara nga Bordi. Organet e gjykimit disiplinor të FTK shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesë-marrësve në veprimtaritë, garat sportive, që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës së FTK-së.
- 16.2. Gjatë veprimtarive sportive të FTK-së, të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohet provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj shikuesve
- 16.3. Organizatori i veprimtarisë sportive të FTK është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarisë sportive dhe, në veçanti, të kujdeset për marrjen e masave parandaluese të shfaqjes së provokimeve e të sjelljeve të tjera të palejuara.
- 16.4. FTK i njeh dhe i kupton përgjegjësitë që i përcaktohen me Ligjin për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Tjera Negative në Ngjarjet Sportive. Ky ligj është në përputhshmëri me Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe është harmonizuar pjesërisht në pjesët e aplikueshme për Republikën e Kosovës me Konventën Evropiane mbi Dhunën e Spektatorit dhe Sjelljen e Pahijshme në Ngjarjet sportive.

17. Doping

- 17.1. Sipas rregullave të ITF nëpërmjet Tennis Anti-Doping Programme (TADP), Federata i organizon garat dhe të gjithë garuesit e pranojnë rregullat e TADP-së si kusht për hyrje dhe pjesëmarrje në gara.
- 17.2. TADP është i përshkruar detajisht në uebfaqen e ITF (www.itftennis.com/anti-doping) dhe në librin e rregullave të publikuar dhe të distribuuar nga ITF në Asociacionet Nacionale dhe është e pranishme nëpërmjet aplikimit për ITF.

18. Dispozita për mënjanimin e konfliktit të interesit të organeve vendim-marrëse

- 18.1. Asnjë anëtar i FTK-së nuk i lejohe të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje kur ai është në kushtet e konfliktit të interesit.
- 18.2. Kandidati për president dhe anëtar të komitetit Drejtues duhet të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave me postin e Presidentit ose Komitetit Drejtues.
- 18.3. Pavarësisht çdo detyrimi tjetër ligjor, çdo person që ka njohuri ose dyshim të arsyeshëm për konflikt interesi të ndonjë zyrtari duhet ta lajmërojë institucionin punëdhënës të zyrtarit ose Agjencinë kundër Korrupsionit.
- 18.4. Palët e prekura nga veprimet e zyrtarit apo cilido person që ka njohuri dhe interesa të ligjshme duhet të ofrojë informata të cilat i kanë në dispozicion lidhur me rastin.

- 18.5. Personi që ofron informata të bazuara për rastet e konfliktit të interesit gëzon mbrojtje në pajtim me ligjin.
- 18.6. Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime:
- 18.6.1. Të kërkojë apo pranojë dhuratë apo përfitim tjetër të padrejtë për vete apo personin tjetër, ose ofertë apo premtim për dhuratë, në mënyrë që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë në kryerjen e detyrës së tij publike;
 - 18.6.2. Të kërkojë, përvetësojë, pranojë shpërblime, dhurata, përfitime apo shërbime të padrejta për vete ose për tjetrin si kompensim për përcaktimin e tij në vendimmarrje;
 - 18.6.3. Të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;
 - 18.6.4. Të premtojë, ofrojë ose japë dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër të padrejtë në këmbim të ndonjë dhurate apo përfitimi të padrejtë real ose të premtuar;
 - 18.6.5. Të ndikojë në kontraktimin, dhënien e punëve apo furnizimeve publike për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;
 - 18.6.6. Të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit;
 - 18.6.7. Të ndikojë në vendimmarrje të organeve legjislative, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e zyrtarit me qëllim të përfitimit të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit;
 - 18.6.8. Të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit;
 - 18.6.9. Të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik;
 - 18.6.10. Të fitojë për vete, personat e afërm dhe të besuar çdo përfitim të padrejtë ekzistues ose të ardhshëm, dhuratë, pjesë në kapital, aksione dhe pasuri nga ndërmarrjet publike me pjesë në kapital ose në aksione të një institucioni ku ai është përfaqësues, përfshirë përfitime të padrejta të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga furnizues apo klientë të këtyre ndërmarrjeve.

19. Dispozitat në lidhje me shpërbërjen e Federatës

- 19.1. Federata pushon punën e saj kur për këtë deklarohen 2/3 e anëtarëve të anëtarësuar në Federatë, ose sipas Ligjit.
- 19.2. Pasuria e gjithëmbarshme e FFK-së do t'i bartet një organi kompetent derisa të mos themelohet federata e re, me të njëjtat qëllime dhe obligime.

20. Dispozitat kalimtare dhe të fundit

20.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Federatës.

20.2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i miratuar më 14 janar 2012 dhe ndryshimet që ai Statut i ka pësuar pas asaj date. Përrjashtim nga kjo bëjnë:

- Struktura e Bordit sipas Statutit të miratuar më 14 janar 2012, e cila vazhdon të mbetet në fuqi deri në Kuvendin e rregullt zgjedhor të vitit 2020, dhe
- Mënyra e funksionimit, numrat dhe mandatet e anëtarëve, si dhe detyrat e përgjegjësitë përkatëse të Këshillave e Komisioneve të Bordit, sipas paragrafit përkatës të nenit 10 të Statutit të datës 14 janar 2012, të cilat vazhdojnë të mbesin në fuqi deri në kohën kur nxerren rregulloret e veçanta përkatëse nga Bordi për t'i zëvendësuar ato.

20.3. Interpretimin final të këtij Statuti e bën Kuvendi i Federatës.

20.4. Ky Statut mund të amandamentohet me rezolutën e Kuvendit të përgjithshëm me 2/3 e shumicës së votave.

Shtojca 1 Lista e anëtarëve dhe të drejtat e votimit

Tabela 1 Lista e anëtarëve aktivë dhe joaktivë të Federatës

#	Anëtari	Vendi	Viti e anëtarësimit	Statusi	Numri i delegatëve
1.	K.T. Prishtina	Prishtinë	1996	Aktiv	3
2.	K.T. Prizreni	Prizren	1996	Aktiv	3
3.	K.T. Peja	Pejë	1996	Aktiv	3
4.	K.T. DielliX	Prishtinë	1997	Aktiv	3
5.	K.T. Gjilani	Gjilan	1999	Joaktiv ¹	1
6.	K.T. Trepça	Mitrovicë	2003	Aktiv	3
7.	K.T. Sporek	Gjakovë	2001	Aktiv	3
8.	K.T. Drenica	Drenas	2004	Aktiv	3
9.	T.K. Graçanica	Graçanicë	2008	Joaktiv ¹	1
10.	K.T. Rilindja	Prishtinë	2009	Aktiv	3
11.	K.T. Rahoveci	Rahovec	2014	Joaktiv ¹	1
12.	T.K. Laki	Mitrovicë V.	2014	Joaktiv ¹	1
13.	T.K. Winner	Graçanicë	2016	Aktiv	3
14.	K.T. Gjakova	Gjakovë	2017	Aktiv	3
15.	K.T. Kalaja	Prizren	2018	Aktiv	3
16.	T.K. Tennis Arena	Llapnasellë	2018	Aktiv	3
17.	K.T. HotShot	Gjakovë	2018	Aktiv	3
18.	K.T. Bifurkacioni	Ferizaj	2021	Aktiv	3
19.	K.T. Istogu	Istog	2021	Aktiv	3
20.	K.T. Vushtrria	Vushtrri	2021	Aktiv	3
21.	K.T. Match-Point	Obiliq	2022	Aktiv	3
Total				A=17, J=4	55

Tabela 2 Lista e ish-anëtarëve të Federatës

#	Ish-anëtari	Vendi	Viti e anëtarësimit	Data e daljes nga anëtarësia
1.	K.T. Sesahr USA	Prizren	2016	24 nëntor 2018

KRYETARI

Prishtinë, 15.09.2022

Jeton Hadërgjonaj

¹ Me vendim të Kuvendit të datës 15 shtator 2022.